



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 13

Prishtinë, më 22 qershor 2011, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Mufera Şinik, Behar Selimi, Albulena Haxhiu, Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Armend Zemaj, Ardian Gjini dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Haki Demolli dhe Ibrahim Makolli.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Petrit Hysaj – OSBE, Arsim Avdijaj – NDI, Natyra Krasniqi - KDI dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 02.06. 2011;
3. Shqyrtimi i Projektligjit 04/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 010 për Noterinë;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L – 018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 02. 06. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 02. 06. 2011, pa vërejtje.

3 Shqyrtimi i Projektligjit 04/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 010 për Noterinë

Komisioni e shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 010 për Noterinë dhe i dha mbështetje propozimit të Arsim Bajramit, që neni 8 në rreshtin e parafundit pas fjalëve „Ministria e Drejtësisë”, fjalët „mund të” hiqen dhe teksti vazhdon si në ligj.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Raporti me amendamentin për Projektligjin nr. 04/L-002 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 010 për Noterinë dhe procedohet për shqyrtim të mëtejme në komisionet kryesore.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit me amendamentin e propozuar nga Komisioni për Legjislacion.

Amendamenti 1

Neni 8, në rreshtin e parafundit pas fjalëve „Ministria e Drejtësisë”, fjalët „mund të” hiqen dhe teksti vazhdon si në ligj.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L – 018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta

Kryetari - E paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L – 018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse ka vërejtje për amendamentet.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/ L – 018 për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e Komisionit Funkcional dhe amendamentet e deputetëve mund të procedohen për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Të ndryshme

Komisioni i shqyrtoi në parim Projektligjin për përgjegjësin e personave juridik për vepra penale dhe P/L për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji nr. 04/L- 030 për përgjegjësin e personave juridik për vepra penale.
2. Të shqyrtohet dhe të miratohet, në parim, Projektligji nr. 04/L- 031 për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi